

BASHKIA KONISPOL
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 467, datë 31.7.2025 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme” vendimit të Këshillit Bashkiak Konispol nr.41, datë 30.09.2025, Bashkia konispol do të organizojë konkurrimin publik për dhënie me qira të sipërfaqes prej 31 320 m² të pasurisë nr 3470/4/1, zona kadastrale 2217, në pronësi të Bashkisë Konispol për zhvillimin e strukturave agroturistike.

Çmimi dysheme i qirasë është 65 000 lekë ha/vit x 3.132 ha = 203 580 lekë/vit, e përlogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 467, datë 31.7.2025 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë :

- a. Garanci financiare të mjaftueshme, të paktën 10 % të vlerës së investimit, për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.
- b. Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c. Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.
- d. Të mos ketë detyrime ndaj Bashkisë Konispol.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet në kuadër të procedurës së konkurrimin është si më poshtë:

- Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre, adresën e subjektit, telefon, email;
- Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë;
- Projektidenë arkitektonike hartuar nga specialistë të licencuar, referuar legjislacionit sektoral për agroturizmin me kushtin që intesiteti indërtimit mos të jetë më i madh se 0.05.
- Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- Raportin e vlerësimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
- Nivelin e punësimit në veprimtari;
- Dokumentacion i cili provon aftësinë për përmbushjen e garancisë financiare në masën jo më pak se 10 % të vlerës së investimit të tilla si: pasqyrat financiare ose/dhe garanci bankare jo më pak se 10 % të vlerës së investimit, kontratë financimi ose letër angazhimi nga banka për sigurimin e vlerës së kërkuar , ose kombinimi të të gjithave parashikimeve në këtë pikë;
- Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;

- Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve
- Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore

Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

a) Projektideja Arkitektonike	20 pikë;
b) Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15 pikë;
c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25 pikë;
d) Nivelin e punësimit në veprimtari	5 pikë;
e) Masën e qirasë për ha/vit	35 pikë.

Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira sipërfaqe kullosore”, i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe duhet të paraqitet pranë protokollit në Bashkinë Konispol deri në datën 07.05.2026, ora 10:00 që është dhe data e hapjes së ofertave.

Për çdo komunikim, material si harta në shkallë 1:10 000 me kufijtë e pronës, apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike bashkiakonispol@gmail.com.